



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data 11 Nëntor 2021

Nr: 466

VENDIM

PËR

**DEKLARIMIN TË PËRFUNDUAR DHE PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË  
PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË SHQYRTIMIT TË REZULTATIT TË  
VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN  
VETËDEKLARUES Z. TOM GJEK DOSHI, KANDIDAT PËR DEPUTET I  
PROPOZUAR NGA PARTIA SOCIALDEMOKRATE E SHQIPËRISË, QARKU  
TIRANË/SHKODËR NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E  
INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË  
FUNKSIONE PUBLIKE”**

Sot më datë 11.11. 2021, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Tom Gjek Doshi, kandidat për deputet i propozuar nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, qarku Tiranë/Shkodër, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Palë të interesuara: Z. Tom Gjek Doshi, kandidat për deputet i listës shumemërore të propozuar nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, qarku Tiranë/Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.

Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe



Data 11 Nëntor 2021  
Nr. 466

Për deklarin të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar të procedurës administrative të shqyrtimit të rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Tom Gjek Doshi, kandidat për deputet i propozuar nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, qarku Tiranë / Shkodër, në zbatim të ligjit nr. 138/2015

95 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

## VËREJ:

### I.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati për deputet”.

Në zbatim të këtyre dispozitave", z. Tom Gjek Doshi, kandidat për deputet i listës shumëmemërore të propozuar nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë qarku Tiranë/Shkodër, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 1754.

Përpara miratimit të listave të kandidatëve për deputetë për subjektin zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë në bazë të kompetencave të veta, KQZ bëri verifikimin prima facie nga i cili konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit dhe ndërmori hapat e mëposhtme:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2191 prot., datë 17.03.2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 2851/1 prot., datë 17.03.2021, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se kandidati për deputet, z. Tom Gjek Doshi, rezultoi i dënuar. Sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 17, datë 16.03.2021 bashkëlidhur përgjigjes, z. Tom Gjek Doshi, rezultoi i dënuar dhe rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2211 prot., datë 17.03.2021, ka kërkuar informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila nga ana e saj me shkresën nr.1156/1, prot., datë 08.04.2021, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se kandidati për deputet z. Tom Gjek Doshi, rezulton të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.
- c. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 157 datë 17.03.2021, vendosi “Miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialdemokrate për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”.

## II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet z. Tom Gjek Doshi.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Tom Gjek Doshi, rezulton se ka deklaruar:

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

**Pyetjes 1**, “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

- Me vendimin nr. 18 datë 25.05.1990, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Rrethit Durrës, e ka dënuar për veprën penale “Sjellje e Padenjë në Shoqëri”, parashikuar nga neni 121 dhe 31/a i K.P, për të cilën është vendosur masa e dënimit 1 (një) vit heqje lirie.

**Pyetjes 4**, “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Është ndaluar/arrestuar nga Prokuroria e Përgjithshme sipas urdhërit të ndalimit të Prokurorit të Përgjithshëm datë 26.03.2015, për periudhën 26.03.2015-28.03.2015, rezultat i së cilës është masa arrest në shtëpi sipas vendimit nr. 15 datë 28.03.2015.

**Pyetjes 5**, “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Është caktuar masë e sigurisë detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore dhe arrest në shtëpi, masa të cilat janë revokuar, nga Gjykata e Lartë.

**Pyetjes 8**, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “PO”, duke deklaruar se:

-Ka jetuar në Adelaide/Australi, për të bashkëjetuar me familjen në vitin 1997 e në vijim.

-Ka jetuar në Heilbronn /Gjermani, për arsye emigracioni në dhjetor 1992.

Duke analizuar përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe deklaratimet e vetë subjektit në formular, sipas të cilave ai pohon se ka qenë i proceduar nga Autoritetet Shqiptare, bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në Kreun V, pika 2, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2443 prot., datë 22.03.2021, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorit të Përgjithshëm, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklaratimeve të bëra.

Me shkresën nr. 519/82 prot., datë 04.11.2021, të administruar nga KQZ-ja me nr. 6840 prot., datë 04.11.2021, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorit të Përgjithshëm, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Tom Gjek Doshi”.

Prokurori i Përgjithshëm, pas kryerjes së gjithë verifikimeve të mundshme brenda dhe jashtë vendit, i konsideron këto verifikime të plota bazuar në përcaktimet e nenit 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Tom Gjek Doshi, sipas të cilit konstatohet:

1. Rezulton në regjistrin themeltar të regjistrimit të popullsisë të vitit 1950 dhe vitit 1974 të ketë emrin “Tomë” dhe emrin e babait “Gjekë”, të regjistruar gabimisht në “Tom” dhe “Gjek” në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, gjatë transkriptimit të kryer më 2001 nga zyra e gjendjes civile në Njësinë Administrative nr. 8, Bashkia Tiranë.
2. Rezulton të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nr. 18, datë 25.05.1990, nga Gjykata e Rrethit Durrës, për kryerjen e kundravajtjes penale “Sjelljes së padenjë në shoqëri” dhe, në bazë të nenit 121 dhe 31/a të Kodit Penal të kohës, është dënuar me 1 (një) vit heqje lirie, duke filluar vuajtja e dënimit nga data 26.02.1990.
3. Rezulton të ketë qënë person nën hetim apo i akuzuar për kryerje të veprës penale:
  - “Plagosjes së rëndë me dashje”, kryer në bashkëpunim dhe “Sjellje e padenjë në shoqëri”, të parashikuar nga nenet 90/2, 13 e 129 të Kodit Penal, në çështjen penale

nr. 95, datë 26.02.1990, nga Prokuroria e Rrethit Durrës, e cila e ka dërguar për gjykim më datë 26.04.1990.

- “Organizimit dhe pjesëmarrjes në grumbullime, manifestime të paligjshme”, parashikuar nga neni 262 i Kodit Penal, në procedimin penal nr.1, datë 20.01.2012, rregjistruar në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila ka vendosur, pushimin e çështjes penale, bazuar në nenin 328/1, germa “d” të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 5 të ligjit nr. 107/2012, datë 08.11.2012 “Për dhënie amnistie”.
  - “Goditjes për shkak të detyrës “parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal, ndryshuar në “Dëmtimeve të tjera me dashje” të parashikuar nga neni 90, prg.2 i Kodit Penal, në procedimin penal nr. 2, datë 13.03.2008, rregjistruar nga Prokuroria e Përgjithshme, e cila më datë 12.04.2008, ka vendosur të pushojë çështjen penale, mbështetur në nenin 59, nenin 328, pika 1, germa “c”, dhe nenin 329 të Kodit të Procedurës Penale.
  - “Kallëzim i rremë”, “Deklarimit të rremë para Prokurorit” dhe “Kanosje për deklarime a dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë”, parashikuar nga neni 305, 305/a, 312/a të Kodit Penal , në procedimin penal nr. 1 datë 20.03.2015, rregjistruar nga Prokuroria e Përgjithshme, e cila e ka dërguar për gjykim, në Gjykatën e Lartë, më datë 23. 06. 2015.
  - “Refuzimit për deklarim, mosdeklarim, fshehje ose deklarim i rremë i pasurive dhe interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose të çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, të parashikuar nga neni 257/a/2 të Kodit Penal, në procedimin penal nr.7, datë 09.06.2015, rregjistruar nga Prokuroria e Përgjithshme, e cila e ka dërguar për gjykim, në Gjykatën e Lartë, më datë 12.06.2017.
4. Nuk rezulton të jetë dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar, për një çështje penale të pa zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë.
5. Rezulton të ketë qenë i ndaluar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, në zbatim të urdhrin të lëshuar më datë 26.03.2015 nga Prokurori i Përgjithshëm, si person i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Kallëzimit të rremë”, “Deklarimit të rremë para prokurorit” dhe “Kanosje për deklarime a dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë”, parashikuar nga nenet 305, 305/a, 312/a të Kodit Penal, për periudhën nga data 26.03.2015 deri më datë 28.03.2015, pasi i është caktuar nga gjykata masa e sigurimit “Arrest në shtëpi”, të parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale.

6. Rezulton të ketë qenë i arrestuar në burg, nga Hetuesia e Rrethit Durrës, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Plagosjes së rëndë me dashje”, kryer në bashkëpunim dhe “Sjellje e padenjë në shoqëri”, të parashikuar nga nenet 90/2, 13 e 129 të Kodit Penal, për periudhën nga datat 26.02.1990 deri më 26.04.1990, dënuar më datën 25.05.1990.
7. Rezulton të ketë qenë i siguruar me masë shtrënguese të sigurisë personale:
  - “Arrest në shtëpi”, të parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar me vendimin nr. 5, datë 28.03.2015, nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, si person i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Kallëzimit të rremë”, “Deklarimit të rremë para prokurorit” dhe “Kanosje për deklarime a dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë”, të parashikuar nga nenet 305, 305/a, 312/a të Kodit Penal, deri më datën 28.04.2015.
  - “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar me vendimin nr.15/1, datë 28.04.2015, nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, si person i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Kallëzimit të rremë”, kryer në bashkëpunim , të parashikuar nga neni 305 - 25 të Kodit Penal, deri më datën 23.06.2015.
8. Rezulton të mos i lejohet hyrja (shpallur “non grata”) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas neni 7031 (c), të Aktit të Përvetësimeve të Konsoliduara FY 2017, të nxjerrë nga Sekretari i Shtetit, njoftuar publikisht më datë 16.04.2018, nga Departamenti Amerikan i Shtetit, për shkak të përfshirjes së tij në korrupsion të lartë.
9. Nuk rezulton të ketë indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion, me qëllim verifikimi:
  - Për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
  - Për qënien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, si i dyshuar për kryerjen e ndonjë veprave penale.
  - Për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë veprave penale prej tij.
  - Dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
  - Përdorimin e të dhënave personale/gjeneraliteteve të tjera.

### III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

Subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, referuar neneve 162 dhe 163 të Kodit Zgjedhor, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 ka fituar 3 (tre) mandate në Kuvendin e Shqipërisë.

z. Tom Gjek Doshi, kandidat i këtij subjektit zgjedhor edhe pse i renditur i pari në listën shumëmemërore të Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën me shkrim, protokolluar në KQZ me shkresën nr. 4500 prot., datë 26.04.2021, nëpërmjet të cilës deklaroi se me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë jep dorëheqjen nga lista shumëmemërore e kandidatëve për deputetë të Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Nëpërmjet kërkesës së tij me shkrim, z. Tom Gjek Doshi, i kërkon KQZ-së të bëjë zëvendësimin e tij si deputet sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu, në shkresën e tij ai shprehet se kërkesa e tij, është në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe se nuk ka, as në datën 26 Prill 2021 (data e nënshkrimit të shkresës) dhe as në të ardhmen asnjë pretendim me vendimin e KQZ-së sipas të cilit mandati i tij i kalon kandidatit tjetër sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor. Dorëheqja është e përvokueshme.

Me vendimin nr. 409 datë 23.06.2021 “Për shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues në zonën zgjedhore, qarku Tiranë”, si dhe me vendimin nr. 410 datë 23.06.2021 “Për shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues në zonën zgjedhore, qarku Shkodër” janë përcaktuar kandidatët fitues të listës shumëmemërore të subjektit zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, sipas të cilëve rezultoi se z. Tom Gjek Doshi, nuk ka përfituar mandatin e deputetit. Në kushtet kur subjekti vetëdeklarues, kandidati i listës shumëmemërore të subjektit zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, nuk do të mund të përfitojë mandat për këtë legjislaturë, Komisioneri nuk mund të shprehet për sa kohë ky subjekt, nuk gëzon statusin e deputetit dhe në asnjë rast e për asnjë rrethanë nuk do të mund të marrë këtë funksion publik për të cilin është iniciuar procedura administrative e verifikimit të thelluar. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur përmbushen kushtet ligjore të moskandidimit, moszgjedhshmërisë apo mbarimit të mandatit për rastet e parashikuara në ligjin 138/2015. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të neneve 10 dhe 11 të ligjit 138/2015, vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i verifikimit të thelluar.





Bazuar në pikat 2 e 3, të nenit 90, dhe në nenin 95, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, është në diskrecionin e organit kompetent të deklarojë të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

### **V E N D O S:**

1. Të deklaroj të përfunduar procedurën administrative pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues z. Tom Gjek Doshi.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

